



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas *Thirrjes për ide të investimeve kapitale komunale nga Instrumenti i Investimeve Kapitale (IIK-CIF) për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban në kuadër të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe në partneritet me UN Habitat Kosova si dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës*, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ngritet Grupi punues për identifikimin dhe hartimin e projekteve ideore inovative, në fushën socio-ekonomike, mjedisore teknike etj, në përbërje:

Ejup Babatinca , Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik,	kryesues
Ismet Kadriu , Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit,	anëtar
Granit Hasani , Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit	anëtar
Rizah Muçolli , Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit	anëtar
Vedat Muçolli , Drejtorja e kulturës Rinisë dhe Sportit	anëtar

Neni 2

Grupi punues, ndër çështje tjera të parapara në Thirrjen për ide të investimeve kapitale komunale, do të identifikojë dhe të hartojë projekte ideore inovative në fushën e rregullimit fizik të objekteve ose infrastrukturës ose shërbimeve të qëndrueshme (socio-ekonomike, mjedisore, teknike etj.) dhe që janë të dobishme për mjedisin dhe komunitetin.

Neni 3

Me projekt ideore do të aplikohet në Instrumentin e Investimeve kapitale (IIK-CIF) për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban me qëllim të vlerësimit paraprak dhe përzgjedhjes së projekteve.

Neni 4

Grupi për punën e tij informon Zyrën e Kryetarit në formë të shkruar.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të Grupit punues
Arkivit

Nr. 02-020/04-0002206/22
Podujevë, 11 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliq





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr. prot. 02-020/04-0094031/21, datë 25 tetor 2021 për formimin e Grupit përfaqësues të Komunës së Podujevës për zbatimin e projektit “ Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2” (ReLOaD2), dhe atë;

Në vend të Ejup Babatinca, caktohet;

Fitim Bunjaku (Menaxher i Personelit) zëvendës koordinator i projektit.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e vendimit nr. 02-020/04-0094031/21, datë 25 tetor 2021.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

*U dërgohet:
Të caktuarit
Koordinatorit të Grupit përfaqësues
Arkivës*

Nr.prot. 02-020/04-0002373/22
Podujevë, 12 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 6 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR MBËSHTETJE DHE OFRIM TË NDIHMAVE NGA KATEGORIA E MJETEVE BUXHETORE SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Neni 1

1. Për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

- 1.1. **Makfirete Zeka**, kryesuese
1.2. **Ahmet Ahmeti**, anëtar

2. Anëtar i tretë i Komisionit, varësisht kërkesave të paraqitura Drejtorive përkatëse, është:

- 2.1. **Avni Maloku**, nga Drejtoria e Arsimit, anëtar
2.2. **Fitore Blakçori**, nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mëirëqenjes Sociale, anëtare
2.3. **Xheladin Çitaku**, nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, anëtar
2.4. **Hamide Aliu**, nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare

Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Rregulloren për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferte, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në kuadër të Rregullores së cekur.


Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në marrjen e një vendimi tjetër.

U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorive të Komunës
Arkivit

Nr. 02-020/04-0002690/22
Podujevë, 13 janar 2022





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 11, 13 dhe 58 shkronjat b), f) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 7 të Rregullores (QRK) nr.27/2018 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, si dhe nenet 14, 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, nxjerrë këtë,

VENDIM PËR EMËRIMIN E ZËDHËNËSIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

1. **z.Fatri Zhitija**, nga fshati Llugë – Komuna e Podujevës, me profesion Sociolog, emërohet;

➤ Zëdhënës i Komunës së Podujevës

2. Mandati i të emëruarit sipas këtij vendimi, është i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Komunës, përveç nëse me vendim të veçantë vendoset ndryshe nga Kryetari i Komunës.

Neni 2

Punët dhe detyrat kryesore të emëruarit sipas nenit 1 të këtij Vendimi, janë të përcaktuara me Rregulloren (QRK) nr.27/2018 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun, me theks nenit 7, si dhe dispozita tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

Paga mujore e të emëruarit përcaktohet sipas rregullativës ligjore në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa për zbatimin kujdesen Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Personelit.

U dërgohet;

Të emëruarit

Zyrës së personelit

Arkivit të Komunës

Nr.prot.02-020/02-0003456/22
Podujevë, 17 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 57.1 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 16 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Shfuqizohet Vendimi nr. 02-352/02-0111954/21, i datës 31 dhjetor 2021 për ndërprerjen e ndriçimi publik në rrugët dhe hapësirat publike në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Vendimi i cekur shfuqizohet për arsye të përmirësimit të gjendjes të furnizimit me energji elektrike në nivel vendi, si dhe në funksion të rritjes së nivelit të sigurisë publike në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

*U dërgohet;
DSHPMSH-së
Arkivës*

Nr. 02-352/02-0003586/22
Podujevë, 17 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 9 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/111-400 me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.01/172-400, merr:

V E N D I M **PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE**

Neni 1

1. Për shkak të humbjes së jetës në aksident trafiku rrugor të Safet Maçastena tashmë i ndjerë nga fshati Velikarekë - Komuna e Podujevës, familja e tij ndihmohet me mjete financiare në shumë 500€.

2. Dhënia e ndihmës financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të kushteve jo të mira ekonomike - sociale dhe me qëllim të përballimit të gjendjes ekonomike të familjes me rastin e humbjes së jetës të familjarit të tyre në aksidentin tragjik të ndodhur më datë 09.01.2022 në fshatin Lupç i Poshtëm të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e nënës së të ndjerit znj.Fexhrie Maçastena.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0004408/22
Podujevë, 20 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 9 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/111-400 me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.01/172-400, merr:

V E N D I M **PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE**

Neni 1

1. Për shkak të humbjes së jetës në aksident trafiku rrugor të Ruzhdi Uka tashmë i ndjerë nga fshati Dumnicë Epërme - Komuna e Podujevës, familja e tij ndihmohet me mjete financiare në shumë 500€.

2. Dhënia e ndihmës financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të kushteve jo të mira ekonomike - sociale dhe me qëllim të përballimit të gjendjes ekonomike të familjes me rastin e humbjes së jetës të familjarit të tyre në aksidentin tragjik të ndodhur më datë 09.01.2022 në fshatin Lupç i Poshtëm të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e bashkëshortes së të ndjerit znj.Hajrije Uka.

Neni 3


Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0004413/22
Podujevë, 20 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 9 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/111-400 me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.01/172-400, merr:

V E N D I M **PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE**

Neni 1

1. Për shkak të humbjes së jetës në aksident trafiku rrugor të Ajdin Brahimi tashmë i ndjerë nga fshati Bakshi - Komuna e Obiliqit, familja e tij ndihmohet me mjete financiare në shumë 500€.

2. Dhënia e ndihmës financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të kushteve jo të mira ekonomike - sociale dhe me qëllim të përballimit të gjendjes ekonomike të familjes me rastin e humbjes së jetës të familjarit të tyre në aksidentin tragjik të ndodhur më datë 09.01.2022 në fshatin Lupç i Poshtëm të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e bashkëshortes së të ndjerit znj.Habibe Brahimi.

Neni 3


Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-004415/22
Podujevë, 20 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Neni 1

z.Vigan Salihu, Fakulteti i Agrobiznesit (Ekonomi e Bujqësisë) nga fshati Dumnicë e Poshtme-Komuna e Podujevës, emërohet;

- **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit ekonomik**

Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit ekonomik do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.


Neni 3

Vendimi hyn në fuqi nga data 24.01.2022.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0004854/22
Podujevë, 21 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË ARSIMIT**

Neni 1

z.Avni Fetahu, MSC i shkencave ekonomike, nga fshati Shtedim-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit**

Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Arsimit do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi nga data 24.01.2022.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0004845/22
Podujevë, 21 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË INSPEKSIONIT**

Neni 1

z.Besnik Mulliqi, MSC i shkencave matematikë – natyrore, drejtimi Kimi, nga fshati Surkish-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit**

Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi nga data 24.01.2022.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0004852/22
Podujevë, 21 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË KULTURËS RINISË DHE SPORTIT**

Neni 1

z.Pajtim Balaj, Bachelor i Shkencave Politike dhe Administratë Publike, dhe Bachelor i Filozofisë, nga Podujeva, emërohet;

➤ **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit**

Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit do t'i ushtrjë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi nga data 24.01.2022.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0004849/22
Podujevë, 21 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE MBROJTJES DHE** **SHPËTIMIT**

Neni 1

z.Bahri Selimi, Jurist, nga fshati Kaçybeg-Komuna e Podujevës, emërohet;

- **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit**

Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi nga data 24.01.2022.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0004853/22
Podujevë, 21 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Billiqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË** **DREJTORISË SË BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT** **RURAL**

Neni 1

z.Fatmir Rudari, Fakulteti Filozofik-Departamenti i Historisë, nga fshati Shajkoc-Komuna e Podujevës, emërohet;

- **Ushtrues i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

Neni 2

I përmenduri punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi nga data 24.01.2022.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0004855/22
Podujevë, 21 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E USHTRUESËS SË DETYRËS TË** **DREJTORIT/ESHËS TË DREJTORISË SË ADMINISTRATËS**

Neni 1

znj.Antoneta Ejupi, Juriste, nga Sekiraça-Komuna e Podujevës, emërohet;

➤ **Ushtruese e detyrës së Drejtoreshës të Drejtorisë së Administratës**

Neni 2

E përmendura punët dhe detyrat e punës në kuadër të Drejtorisë së Administratës do t'i ushtrojë deri në emërimin e drejtorit/eshës të Drejtorisë së cekur.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi nga data 24.01.2022.

I dërgohet:
Të emëruarës
Zyrës së personelit
Arkivit

Nr. 02-020/02-0004842/22
Podujevë, 21 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në neneve 13 dhe 58 shkronjat (b,g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Valon Shabani, zyrtar i të hyrave financiare në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, autorizohet për kryerjen e punëve dhe detyrave nga pozita e zyrtarit certifikues në kuadër të Drejtorisë së cekur.

Neni 2

Autorizimi i të përmendurit bëhet për shkak të mungesës së zyrtarit certifikues me rastin e shkuarjes në pension dhe i njëjti vlen deri në përzgjedhjen e zyrtarit certifikues sipas procedurave të rekrutimit të cilat janë në proces.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën e Personelit

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

U dërgohet:
Të autorizuarit
DBF dhe Zyrës së Personelit
Arkivës

Nr.prot.02-020/05-0004940/22
Podujevë, 21 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Për hartimin e draft Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, n'kuadër të Komunës së Podujevës, ngritet Grupi punues në këtë përbërje:

- | | |
|---|----------------------|
| 1. Fatlum Osmani , Drejtorja e Buxhetit dhe Financave - UD drejtor, | Koordinator i Grupit |
| 2. Avni Fetahu , Drejtorja e Arsimit - UD drejtor, | anëtar |
| 3. Pajtim Balaj , Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit - UD drejtor, | anëtar |
| 4. Driton Veliu , Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - UD drejtor, | anëtar |
| 5. Fatmir Rudari , Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - UD drejtor, | anëtar |
| 6. Vigan Salihu , Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik - UD drejtor, | anëtar |
| 7. Bahri Selimi , Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - UD drejtor, | anëtar |

2. Zyra Ligjore, është pjesë përbërëse e Grupit punues gjatë procesit të hartimit të Draft Rregullores së cekur.

Neni 2

Drafti i Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve të përgatitet në afatin optimal dhe i njëjti i prezantohet Zyrës së Kryetarit.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.02-020/04-0006055/22
Podujevë, 27 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja (g) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës nr.04/L-042 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me ligjet nr. 04/L-237 dhe 05/L-092, si dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës të Prokurimit, Kryetari i Komunës, nxjerr:

V E N D I M **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT** **nr. 02-020/04-0065862/20 datë 30.10.2020**

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komisionit sipas Vendimit nr. 02-020/04-0065862/20 për ngritjen e Komisionit për pranimin e punëve të kryera i datës 30.10.2020, sipas aktivitetit të prokurimit” Servisimi i automjeteve të institucioneve komunale”, me nr. prokurimit 615-20-5177-221(nr i brendshëm 098), dhe atë :

Në vend të **Idriz Kadriu**, caktohet kryesues i komisionit **Lutfi Kastrati**, vozitës në Administratën komunale dhe i autorizuar për

Neni 2

Zëvendësimi bëhet për arsye të shkuarjes në pension të Idriz Kadriut.

Neni 3


Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit nr. 02-020/04-0065862/20 datë 30.10.2020

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-020/04-0006538/22
Podujeve, 28 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë nr.prot.02-400/04-0006037/22 të datës 27.01.202, të Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE OJQ-KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

- 1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- 2.Mbështetja financiare publike e OJQ-Klubeve sportive në Komunën e Podujevës, në fushën e aktiviteteve sportive: ofrohen nga Buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85005.

Neni 2

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit sipas Rregullores MF-Nr.04/2017.
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 - 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 2.3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
 - 2.4. Deklarata e Partneritetit

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-615/03-0006569/22
Podujevë, 28 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF - Nr – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në kërkesë nr.02-400/04-0006039/22 të datës 27.01.2022 të Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË KOMUNËN E PODUJEVËS NË FUSHËN E SHFAQJEVE TEATRORE

Neni 1

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve në Komunën e Podujevës bëhet në fushën e aktiviteteve kulturore për shfaqje teatrore në Teatrin e Qytetit “Avdush Hasani”, nga buxheti i Komunës së Podujevës, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85142.

Neni 2

Mjetet e financiare shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, pas vlerësimit dhe përzgjedhjes nga ana e komisionit si dhe dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përshinë:
 - 1.1. Teksti i thirrjes publike
 - 1.2. Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3. Formularët e aplikimit sipas Rregullores MF-Nr.04/2017.

Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>.

Neni 5

1.Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2.Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3.Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 6


Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.


Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-615/03-0006571/22
Podujevë, 28 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, merr:

V E N D I M

Neni 1

Me qëllim të realizimit të projektit “Kolektori i ujërave të zeza Gërdoc-Lluzhan”, ngritet grupi punues në përbërje:

Liman Zeqiri , shef i Zyrës komunale për komunitete dhe kthim	kryesues
Bujar Gimolli , zyrtar i lartë për komunikim me publikun	anëtar
Ahmet Ahmeti , koordinator i Njesisë për të drejtat e njeriut	anëtar

Neni 2

Grupi punues obligohet të mbajë takimet me banorët e lokaliteteve përgjatë të cilave shtrihet kolektori, duke siguruar pëlqimet e tyre përmes nënshkrimeve nga ana e banorëve lokal.

Neni 3

Procesi i realizimit të debateve me banorët e lokaliteteve të cekura dhe marrjes së pëlqimeve përmes nënshkrimeve të tyre është një prej kriterëve për aplikim nga ana e Komunës së Podujevës në Ministrinë e Pushtetit Lokal - në *Instrumentin e Investimeve Publike*, proces i cili duhet të përfundojë më së largu deri më 10 shkurt 2022.

Neni 4


Grupi punues për punën e kryer në formë të shkruar informon Zyrën e Kryetarit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.02-020/04-0006810/22
Podujevë, 31 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shequm Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore 2023-2024 nr. 01-400/03-0003128/22, datë 14.01.2022, në rekomandim të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002690/22, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas kërkesës nr. 12-320/01-0000681, dt. 06.01.2022, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

z. Visar Vokri fermer nga fshati Sfeçël, Komuna e Podujevës, përkrahet/subvencionohet me mjete financiare në shumë 5000€.

Përkrahja financiare sipas këtij neni bëhet me qëllim të ndihmës në përbushjen e obligimeve të tija financiare që rrjedhin nga financimit i përbashkët sipas Marrëveshjes së Partneritetit nr. 11/2022, datë 27.01.2022, të lidhur në mes Organizatës Promoting Private Sector Employment -PSPE dhe fermerit Visar Vokri për implementimin e projektit për mbjelljen e fidanëve si dhe në funksion të rimëkëmbjes ekonomike të fermerit, si pasojë e dëmeve dhe humbjeve të shkaktuara në vitin 2020, nga pandemia covid 19.

Vlera totale e projektit është 60000 € dhe realizohet përmes financimit të përbashkët, dhe atë 50% nga ana e fermerit-Visar Vokri dhe 50% nga Organizata PSPE.

Neni 2

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0006831/22
Podujevë, 31 janar 2022

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

